



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më.08.korrik.2011
Ref.Nr.:126/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

për

Kërkesën nr. KI-41/11

Parashtruesi

Shefki Gjergji

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
A nr. 274/2010 të 22 shtatorit 2010**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Shefki Gjergji nga fashti Obranqë, Komuna e Podujevës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës 274/2010 të 22 shtatorit 2010 me të cilin është hedhur poshtë ankesa e tij ndaj vendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamentit të Administratës Pensionale të Kosovës nr. 50040570 të 20 nëntorit 2009.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës e konteston aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës 274/2010 të 22 shtatorit 2010 duke konsideruar se është shkelur neni 49 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

4. Nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të datës 16 dhjetor 2008 (në tekstin e mëtejme: “Ligji”) dhe rregulli 56.2 i Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: “Rregullorja e Punës”).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën më 21 mars 2011 në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: “Gjykata”).
6. Më 23 mars 2011, Gjykata Kushtetuese e njoftoi Gjykatën Supreme të Kosovës për kërkesën e paraqitur.
7. Më 10 maj 2011, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka siguruar dëshmi se Parashtruesi i kërkesës e ka pranuar aktgjykimin e Gjykatës Supreme më 2 tetor 2010.
8. Më 10 qershor 2011, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit Altay Suroy Kolegji Shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët Almiro Rodrigues (kryesues), Gjyljeta Mushkolaj dhe Snezhana Botusharova, i propozoi Gjykatës së plotë refuzimin e kërkesës si të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës ka kërkuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamentit të Administratës Pensionale që si organ i shkallës së parë t'i njeh të drejtën për pension si person me aftësi të kufizuar për punë. Mirëpo organi i shkallës së parë e ka refuzuar këtë kërkesë më 19 tetor 2009 në bazë të nenit 3 të Ligjit 2003/23 për pensionet e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë.
10. Organi i shkallës së parë e ka bazuar mendimin e tij në konstatimin dhe mendimin e komisionit mjekësor të organit të shkallës së parë të dhënë më 15 tetor 2009, se parashtruesi i kërkesës nuk i ka plotësuar kushtet e parapara me ligj për pensionet e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë.
11. Për më tepër, në procedurën e shkallës së dytë para Bordit për Ankesa të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamentit të Administratës Pensionale, organi i paditur ofroi vlerësimin për aftësinë e kufizuar të organit faktik (organit të trupit) të dhënë më 8 dhjetor 2009 me nr. 5004057, i cili përputhej me konstatimet dhe mendimin e komisionit të mëparshëm, dhe mbi këtë bazë ankesën e parashtruesit e hodhi poshtë si të pabazë dhe e konfirmoi vendimin e kontestuar.

12. Duke marrë parasysh se komisionet mjekësore, të cilat janë të autorizuar me ligj, kanë konstatuar se nuk ekziston aftësia e kufizuar tek parashtruesi i kërkesës dhe se në mënyrë të drejtë kanë zbatuar ligjin për pensionet e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë, Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar se nuk ka pasur shkelje të ligjit, dhe kësisoj me aktgjykimin A. nr. 247/2010 të 22 shtatorit e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të pabazuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

13. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës 274/2010 të 22 shtatorit 2010 me të cilën është hedhur poshtë ankesa e tij ndaj vendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamentit të Administratës Pensionale të Kosovës nr. 50040570 të 20 nëntorit 2009, është bërë shkelje e të drejtave të tij të garantuara me nenin 49 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

14. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, është e nevojshme që Gjykata së pari të analizojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat për pranueshmëri të parapara me Kushtetutë, si dhe të cekura në Ligjin dhe Rregulloren e Punës.

15. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit i cili parashikon se:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi.”

16. Në bazë të dokumentacionit të parashtruar mund të konstatohet se parashtruesi i kërkesës nuk e ka paraqitur kërkesën brenda afatit të paraparë kohor sipas nenit 49 të Ligjit.
17. Vendimi i fundit i Gjykatës Supreme të Kosovës A. Nr. 247/ 10 i cili është nxjerrë më 22 shtator 2010, i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 2 tetor 2010 (dëshmi: fletëpranimi i Gjykatës Supreme të Kosovës), përderisa ai e ka dorëzuar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 21 mars 2011. Rrjedhimisht kërkesa është e parashkruar, sipas nenit 49 të Ligjit.
18. Pas shqyrtimit të të gjitha dëshmive dhe argumenteve për objektin e çështjes, dhe pas diskutimit të çështjes, Gjykata erdhi në përfundim se kërkesa ishte paraqitur pas skadimit të afatit prej 4 muajsh, nga dita kur vendimi i fundit i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullat 36 (1b) dhe 56 (2) të Rregullores së Punës, në seancën e mbajtur më 10 qershor 2011, njëzëri

VENDOS

- i. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- ii. Që ky vendim t'u dërgohet palëve dhe të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- iii. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani

